



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1/292  
Datë: 29/5/2023

Bazuar në nenin 178 paragrafi 8 të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, Senati i Universitetit të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me datë 15.05.2023 nxjerr:

**RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN, NDRYSHIMIN DHE ZBATIMIN E NENIT 15 TË  
RREGULLORES NR. 886 DATË 27.04.2022**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Përmes kësaj Rregulloreje (Aneks Rregullore) plotësohen dhe ndryshohen paragrafi 3 dhe 4 i nenit 15 të Rregullores Nr. 886 datë 27.04.2022 për Procedurat Përzgjedhëse lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (Rregullorja), dhe bazuar në paragrafin 5 të këtij neni, me qëllim të zbatimit të tij, përcaktohen procedurat, emërimi i komisionit vlerësues, komisioni i veçantë i ankesave; konflikti i interesit dhe shmangia e nepotizmit.

**Neni 2**  
**Plotësimi dhe ndryshimi i paragrafit 3 dhe 4 të nenit 15**

1. Paragrafi 3 i nenit 15 të Rregullores ndryshohet si në vijim:
  3. Propozimi i Dekanit duhet të jetë i arsyetuar edhe sa i përket superioritetit akademik të anëtarëve të komisionit. Anëtar të Komisionit të veçantë vlerësues mund të emërohen profesorë nga njësia akademike e UP-së (deri në 2 anëtarë) dhe anëtarë ndërkombëtar nga universitet me renome botërore, të ranguar në mesin e 400 universiteteve me të mira sipas World University Rankings (<https://www.topuniversities.com/qs-world-university-rankings>).
2. Paragrafi 4 i nenit 15 të Rregullores ndryshohet si në vijim:
  4. Për punimet e publikuara të kandidatëve që aplikojnë për pozitat e reja, aplikohen kufizimet e vendosura në paragrafin A3 të shtojcës II të Rregullores.

### Neni 3

#### Procedura, emërimi i komisionit vlerësues dhe parimet e përgjithshme për zbatimin e nenit 15 të Rregullores

1. Konkursi publik në lidhje me zbatimin e nenit 15 të Rregullores për rekrutim të veçantë të personelit akademik, për pozita të reja mund të shpallet si aneks i konkursit të rregullt të UP-së për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, ose si konkurs i veçantë.
2. Për aspektet e procedurës që nuk janë të përcaktuara në nenin 15 të Rregullores dhe me këtë Aneks Rregullore, zbatohen dispozitat e Rregullores në fuqi për Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të UP-së.
3. Komisioni vlerësues për pozitat e reja, në përbërje prej 5 anëtarëve, siç përcaktohet në nenin 15 të Rregullores dhe me këtë Aneks Rregullore, emërohet nga Senati i UP-së, jo më larg se 30 ditë nga mbyllja e konkursit. Rektori mund të vendos që ky afat të shtyhet edhe për 15 ditë të tjera.
4. Komisioni vlerësues do të mund të propozoj për zgjedhje vetëm kandidatët të cilët kanë përfunduar një nivel të studimeve në njërin nga 400 universitetet me të mira sipas World University Rankings (<https://www.topuniversities.com/qs-world-university-rankings>).
5. Komisioni duhet të vlerësoj dhe analizoj me kujdes programin e studimit jashtë vendi për secilin kandidat që propozon, duke arsyetuar se programi (Bachelor, Master apo Doktoratë), përmbajtja e tij, lëndët e përfshira, ose specializimet dhe studimet tjera që ka kryer kandidati/ja e bëjnë të përshtatshëm/e për t'u zgjedhur në pozitën në të cilën ka aplikuar. Në dhënien e mendimit për zgjedhjen dhe vlerësimin e fushës së studimit, Komisioni mund të bazohet edhe në programin dhe përgatitjen e kandidatit për pjesën e studimeve të kryera në Universitetin e Prishtinës, nëse kandidati/ja një ose disa nivele të studimit i kanë përfunduar në UP.
6. Kandidatët përveç tjerash, duhet të dorëzojnë edhe një arsyetim të profilit të programit të studimit, përshkrim të lëndëve, fushës së specializimit të tyre, si dhe të dhëna të tjera që mund të jenë relevante për pozitën në të cilën ka aplikuar.
7. Komisioni mund të realizoj intervistë me kandidatët që aplikojnë për pozitat e reja të shpallura nga UP sipas nenit 15 të Rregullores. Intervista mund të realizohet me prezencë fizike ose online. Për mbajtjen ose jo të intervistës vendos Komisioni vlerësues me shumicë të votave.
8. Komisioni vlerësues brenda një afati prej 30 ditëve nga emërimi e dorëzojnë Raportin për kandidatët për Zyrën për Zhvillim Akademik dhe Rektoratit të UP-së, për publikim. Me vendim të Rektorit ky afat mund të zgjasë më së shumti edhe 30 ditë të tjera.
9. Pas afatin prej 15 ditëve nga shpallja/publikimi i raportit, kandidatët e pakënaqur mund të paraqesin ankesë në afat prej 7 ditëve.

**Neni 4**  
**Komisioni i veçantë i ankesave**

1. Komisioni i veçantë i ankesave përbëhet nga 3 anëtarë. Anëtarët e komisionit të ankesave janë përfaqësues nga personeli akademik i fakultetit përkatës.
2. Anëtarët e komisionit të ankesave nuk mund të jenë nga strukturat udhëheqëse të fakultetit dhe departamenteve përkatëse si dhe jo anëtar të komisioneve vlerësuese.
3. Komisioni, me propozimin e Rektorit, pas konsultimit me Dekanin e njësisë akademike, emërohet nga Senati. Komisioni ka për detyrë të shqyrtoj ankesat pas shpalljes së raporteve vlerësuese.
4. Komisioni i paraqet raport me shkrim Senatit të UP-së në një afat prej 15 ditëve nga përfundimi i afatit për ankesa kundër raportit të komisionit vlerësues. Gjithashtu ky komision në raportin e tij, mund t'i rekomandoj Komisionit vlerësues që të plotësoj, të rishqyrtoj ose arsyetoj aspekte të caktuara të raportit vlerësues dhe propozimeve të dhëna.
5. Pas vendimit të Senatit për zgjedhjen apo moszgjidhjen e kandidatëve të shpallura me konkurs publik, për ankesat ndaj këtij vendimi është kompetent që të vendos Komisioni i ankesave dhe parashtresave i Senatit.

**Neni 5**  
**Konflikti i interesit dhe shmangia e nepotizmit**

1. Nuk mund të zgjedhën emërohen sipas procedurës së përcaktuar në nenin 15 të rregullores, kandidatët që kanë ose kanë pasur deri në 2 vitet e fundit të punësuar në njësinë akademike përkatëse, persona në marrëdhënie familjare.  
Marrëdhënie familjare me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe nepotizmit konsiderohet raporti - bashkëshort ose person që bashkëjeton, i afërm në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërm në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adaptues, të adaptuar, në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë.

**Neni 6**  
**Dispozitat përfundimtare**

1. Më hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen paragrafi 3 dhe 4 i Rregullores Nr. 886 datë 27.04.2022.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit.



Rektori

Prof. dr. Qerim Qerimi